AKT - THEMELIMI

i

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI

TË KUFIZUAR "RUÇI" SH.P.K.BURREL.

Në Burrel, sot me datën 20 Janar 2000 unë i nënshkruari Asllan Ruçi i biri i Aqifit dhe i Koleres i datëlindjes 28.02.1968 lindur në fshati Zenisht dhe me banim në lagjen " Pjetër Budi " të qytetit Burrel me vullnetin tim të lirë vendosa që të krijojë shoqërinë tregtare private me përgjegjësi të Kufizuar " Ruçi" Sh.p.K.Burrel.

H Y R J E

Në kuptimin e këtij akti themelues Ortaku i vetëm themelues Asllan Ruçi është themeluesi i shoqërisë tregtare private Ruçi Sh.p.K.Burrel. Qëllimi i këtij akti themelues është krijimi i shoqërisë tregtare private Ruçi me qendër në lagjen Pjetër Budi të qytetit Burrel dhe me shtrirje në të gjith teritorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria tregtare private " Ruçi" Sh.p.K. Burrel rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me aktin e themelimit, statutin e saj, me ligjin nr.7512 datë 10 gusht 1991, kodin tregtar ( ligji nr.7638 dt.19 nëndor 1992 dhe aktet e tjera të lëgjislacionit shqiptar).

Objekti i veprimtarisë ekonomike i kësaj shoqërie do të jetë :

Tregëtimi me shumicë e pakicë i mallërave të ndryshme industriale, ushqimore, blegtorale, bujqësore, pjesë këmbimi, makineri e paisje, materiale elektrike e ndërtimi, përpunim e tregëtim lënde drusore, kërkim, shfrytëzim e tregëtim mineralesh, import eksport, karburante e lubrifikante, punime ndërtimielektrike, trasport mallërash e pasagjerë, punime e shërbime të tjera të ndryshme.

AFATI I VEPRIMTARISË

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë efektive nga dita e rregjistrimit në rregjistrin tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë si dhe me paisjen me lejen e ushtrimit të profesionit nga organet kopetente.

Aktiviteti privat do të zhvillohet me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar " Ruçi " Sh.p.K. Burrel përbëhet nga shuma prej 100.000 lekë në Bankën e Kursimeve Dega Burrel.

Kapitali themeltar është formuar në masë të plotë nga Ortaku i vetëm themelues Asllan Ruçi si rezultat i veprimtarisë së tij private.

Ortaku i vetëm themeluesi ose persona të tjerë të autorizuar prej tij kanë të drejtë që me nxjerrjen e bilanceve periodike ose vjetore të përfitojnë përqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetrore,sigurimet shoqërore etj.Për shkelje të ndryshme e të mundëshme të parashikuara në statut,Ortaku themelues mund të marrë masa ndëshkimore,ndaj kujt do që dëmton pasurinë e shoqërisë.

JURIDIKSIONI

Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar " Ruçi " Sh.p.K.Burrel e ka qendrën e saj në lagjen Pjetër Budi të qytetit Burrel.

Të gjitha mosmarrëveshjet me personat juridik e financiar,vendas dhe të huaj si dhe me organet shtetrore zgjidhen me mirëkuptim në të kundërtën zgjidhja e tyre mund të bëhet në Gjykatën e Rrethit të Tiranës.

ORTAKU I VETËM THEMELUES
( ASLLAN RUÇI )

Ky akt themelimi u pregadit
nga Unë;
A V O K A T I
( Hajredin Hysa )

AVOKAT
Hajredin Hysa
MAT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERE VJOLLCA SKENDO
NR. 274 ReP.
NR. 15 Kol.

V Ë R T E T I M

Në Tiranë sot me datën 22.01.2000,përpara meje Noteres Vjollca Skendo,u paraqit personalisht shtetasi Asllan Ruçi,me banim në lagjen Pjetër Budi të qytetit Burrel,madhor dhe me zotësi për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi i tij personal me nr.118527 i cili deklaroi se akti i themelimit të shoqërisë tregtare "Ruçi" Sh.p.K.Burrel i bërë jashtë kësaj zyre është bërë sipas vullnetit të tij të lirë dhe se nënshkrimet në të janë të tijat ndaj unë noterja e vërtetoi atë në bazë të ligjës.

N O T E R E
( Vjollca Skendo )

PULLE TAKSE
50 LEKE
R.SHQIPERISE

**S T A T U T I**

**i**

**"SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " RUÇI "SH.P.K.BURREL.**

Në bazë të ligjit nr.7512 dt. 10 gusht 1991 " Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe privatizimit, veprimtarisë së pavarur dhe privatizimit " të kodit tregtar dhe të akteve të tjera ligjore sot me datën 20.01.2000 unë Ortaku i vetëm themelues Aslan Ruçi me banim në lagjen Pjetër Budi të qytetit Burrel me vullnetin tim të lirë e të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar vendosa që të krijojë shoqërinë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar " Ruçi " Sh.p.K.Burrel.

**K R E U - I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar " Ruçi " Sh.p.K. Burrel është person juridik i pavarur, ka të drejta dhe detyrime për të cilat përgji gjet brenda kufijëve të përcaktuar në ligjin nr.7512 dt.10 gusht 1991, kodit tregtar dhe akteve të tjera ligjore.

**Neni 2**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar " Ruçi " Sh.p.K.Burrel e ushtron veprimtarinë e saj private në bazë të ekonomisë së tregut të lirë.

**Neni 3**

Ortaku i vetëm themelues ka derdhur në këtë sipërmarrje kapitalin e tij me qëllim që të përfitoi të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private si dhe të përballoi humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapacitetin fillestar.

**Neni 4**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar " Ruçi " Sh.p.K.Burrel është person juridik dhe përfiton zotësinë për të vepruar me rregjistrimin në Gjykatën e rrethit Tiranës si dhe me paisjen me lejen e ushtrimit profesionit nga organi kopetent.

**QENDRA, EMËRI, TERITORI**

**Neni 5**

Emërtimi i shoqërisë do të jetë : Shoqëria tregtare private me Përgjegjësi të kufizuar " Ruçi" Sh.p.K.Burrel.

**Neni 6**

Selia e shoqërisë tregtare " Ruçi " Sh.p.K.Burrel do të jetë në lagjen Pjetër Budi të qytetit Burrel. Shoqëria mund të zhvilloi aktivitetin e saj dhe të çel filiale në të gjithë teritorinë e Republikës

së shoqërisë.

## OBJEKTI

### Neni 7

Objekti i veprimtarisë dhe aktiviteti i kësaj shoqërie do të jetë :
Tregëtimi me shumicë e pakicë i mallërave të ndryshme industriale, ushqimore,blegtorale,bujqësore,pjesë këmbimi,makineri e paisje,material elektrike e ndërtimi,prodhim,përpunim e tregëtim të lëndës drusore, kërkim shfrytëzim e tregëtim mineralesh,import eksport,karburante e lubrifikante,punime ndërtimi dhe elektrike,trasport mallërash e pasagjerë punime e shërbime të tjera të ndryshme si dhe çdo aktivitet tjetër që veçmas ose së bashku me ato të përmendura më sipër do të konsiderohen t përshtatshëme për rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë.

## AFATI I VEPRIMTARISË

### Neni 8

Aktiviteti tregtar i shoqërisë do të zhvillohet në një afat të pa caktuar mbi 10 vjet.

### Neni 9

Shoqëria është e detyruar që të mos e ndryshoi destinacionin e saj. Ndryshimi i distinacionit të veprimtarisë ekonomike e financiare brenda dy vjetësh mund të bëhet me lejen e organeve kopetente shtetrore.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 10

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare " Ruçi " Sh.p.K.Burrel përbëhet nga shuma prej 100.000 lekë që janë depozituar në Bankën e Kursimeve Dega Mat.

### Neni 11

Trasferimet e kapitalit themeltar vërtetohen me akt noterial.Shoqëria apo të tretët duhet të respektojnë këto trasferime sapo ti bëhen të ditura asaj.

### Neni 12

Pjesët e kapitalit themeltar janë të trasferueshme në rrugë trashgimie Ato mund tu kalojnë bashkëshortëve,paraardhësve dhe pasardhësve.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV

### Neni 13

Shoqëria tregtare " Ruçi "Sh.p.K.Burrel do të ketë si administrator ortakun e vetëm themelues z.Asllan Ruçi ndërsa si drejtuese teknike z.Dylbere Kola.Ortaku themelues ka të drejtë që të caktoi si administrator edhe persona të tjerë të cilët nuk kanë cilësinë e ortakut.

Neni 14

Ortaku i vetëm themelues ka në kopetencë :

- Të miratoi programin e shoqërisë,të hartojë raportin e administrimit të iventarit,llogarit vjetore të cilat hartohen brenda 1 afati 6 mujor duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.
- vendos për shpërberjen e shoqërisë.
- vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullon marrdhëniet e punësimit e të shpërblimit brenda shoqërisë
- sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organet shtetrore,personave juridik vendas dhe të huaj.
- e të tjera

KREU i II

Neni 15

Shoqëria tregtare " Ruçi " Sh.p.K.Burrel mund të lidh kontrata me sektor shtetror drejpërdrejt me tregun e lirë si dhe me persona juridik e fizik,vendas dhe të huaj sipas legjislacionit në fuqi për eksport importin.

Neni 16

Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga administratori i saj z.Asllan Ruçi ose persona të tjerë të autorizuar prej tij.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë dhe punonjësit e saj.

Neni 18

Sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve-të tjera ligjore,shoqëria përgjigjet për kontabilitetin fiskal,afatet e derdhjes së detyrimeve ndaj shtetit,sigurimet shoqërore etj.

Sipas ligjeve të tatimit mbi fitimin përcaktohen tatimet për veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë të:çel llogari pranë Bankave të vendit të huaj në shqipëri dhe të kryej veprimet e likujdimit ndërmjet tyre.

Neni 19

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të ve financohet në lekë ose valutë të huaj.

Neni 20

Shkëmbimin e monedhës shqiptare në monedh të huaj e anasjelltas mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e shtetit Shqiptare ose në tregun e lirë privat të valutës.

Neni 21

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas Çmimeve i cakton vet shoqëria.

Çmimet dhe tarifat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertës.

Neni 22

Për pasqyrimin e aktivitetit tregtar administratori ose persona të tjerë të caktuar nga ortaku i vetëm themelues janë të detyruar të mbajn dokumentacion të rregullt financiar dhe rregjistra përkatës sipas ligjeve të veçanta.

K R E U i III

MARRDHËNIET E PUNËSIMIT

Neni 23

Themeluesi i shoqërisë për realizimin e veprimtarisë merr në punë punonjës me kontratë pune vjetore ose sezionale.

Neni 24

Punonjësit gëzojnë lejen e zakonshme dhe leje plotësuese sipas kritereve të përcaktuara të përcaktuara në kontratën e punës dhe në mungesë të tyre sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Ortaku themelues z;Asllan Ruçi.Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore,ose me vet kërkesën e të interesuarit.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 26

Të ardhurat neto pas shlyerjes së detyrimeve,fiskale sigurimeve shoqërore etj kalojnë në pronësi të ortakut të vetëm.

Neni 27

Shpërblimi për personat e punësuar në veprimtarinë tregtare të shoqërisë " Ruçi " Sh.p.k.Burrel caktohet sipas kontratës së punës Ndryshimi në pagë vendoset nga themeluesi i shoqërisë.

Neni 28

Fitimi që do të shpërndahej përbëhet nga fitimi i viti financiar të cilit i janë zbritur ose shtuar numërat respektiv të humbjeve apo të fitimeve të mbartura nga vitet e mëparëshme.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

Ortaku i vetëm themelues me rastin e shtimit të ortakëve ka të drejtë të bëjë ndryshimet e nevojshme në statut si dhe të hartoi edhe kontratën e përbashkët me ortakë të tjerë duke bërë ndryshimet e nevojshme në rregjistrin tregtar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë.

Neni 30

Mosmarrëveshjet e shoqërisë në marrdhënie me persona juridik e fizik, vendas dhe të huaj zgjidhen me mirëkuptim,në të kundërtën kur kjo zgjidhje nuk arrihet,zgjidhen nga Gjykata e rrethit të Tiranës.

Neni 31

Përsa nuk është parashikuar në këtë statut i referohet ligjit me nr.7512 dt.10 gusht 1991,Kodit tregtar të Republikës së Shqipërisë si dhe çdo akti tjetër ligjor të legjislacionit shqiptar.

Neni 32

Statuti përpilohet në disa kopje për t'ju dërguar organeve kopetente Një kopje si pjesë e dokumentacionit të formimit të shoqërisë i mbetet asaj,pra shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar " Ruçi " Sh.p.K. Burrel.

Ky statut u nënshkrua në Burrel sot me dt.20.01.2000

ORTAKU I VETËM THEMELUES

ASLLAN RUÇI

Ky statut u pregadit nga

unë Avokati

( Hajredin Hysa )

AVOKAT Hajredin Hysa MAT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERE VJOLLCA SKENDO

NR. 231 Rep.

NR. 16 Kol.

VËRTETIM

Në Tiranë sot me dt. 22.01.2000,përpara meje noteres Vjollca Skendo u paraqit personalisht shtetasi Asllan Ruçi me banim në Lagjen Pjetër Budi të qytetit Burrel,madhor e me zotësi për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi i tij personal me nr.118527, i cili më solli për të vërtetuar statutin e shoqërisë tregtare " Ruçi " Sh.p.K.Burrel dhe deklaroi se ky statut i hartuar jashtë kësaj zyre është bërë sipas vullnetit të tij të lirë dhe se është nënshkruar prej tij,ndaj unë në bazë të ligjës e vërtetoi atë.

N O T E R E

( Vjollca Skendo )

